

Në bazë të Deklaratës së Bolonjës dhe Parimeve të Salzburgut si dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 23 e Ligjit për arsimin e lartë, (Fletorja zyrtare e R. së Maqedonisë, numër 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13 and 41/14) dhe nenit 61 të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2014 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR STUDIMET E CIKLIT TË TRËTË**

### **Dispozitat themelore**

#### *Neni 1*

Studimet e ciklit të tretë udhëhiqen nga parimet themelore në vijim:

- Qëllimi kryesor i studimeve të doktoratës është avansimi i njohurive përmes hulumtimit origjinal i cili përmbush nevojat e tregut të punës edhe përtej komunitetit akademik.
- Programet e doktoratës dhe trajnimi hulumtues janë të dizajnuara për të përmbushur sfidat e reja dhe përfshijnë mundësitë e duhura profesionale për zhvillim të karrierës.
- Diversiteti i pasur i programeve të doktoratës është i rëndësishëm dhe duhet mbështetur me cilësi dhe praktikë të mirë.
- Kandidatët e doktoratës janë hulumtues në fazën e hershme dhe njihen si profesionistë me të drejta adekuate që japin një kontribut kyç në krijimin e njohurive të reja.
- Mbikëqyrja dhe vlerësimi bazohen në kornizë kontraktuese transparente të përgjegjësive të ndara mes kandidatëve të doktoratës, mbikëqyrësve dhe të institucionit (ose edhe partnerëve të tjerë sipas nevojës).
- Studimet e doktoratës janë të strukturuar të zgjedhin sfidat e trajnimit ndërdisiplinor dhe zhvillimit të shkathësive të bartëshme.
- Programet e doktoratës kërkojnë dhe ofrojnë mobilitet gjeografik si dhe mobilitet ndërdisiplinor dhe ndërsektorial dhe bashkëpunim ndërkombëtar brenda një kornize të integruar bashkëpunimi mes universiteteve dhe partnerëve të tjerë.

### **Dispozitat hyrëse**

#### *Neni 2*

Kjo Rregullore rregullon realizimin e programeve studimore të ciklit të tretë në kuadër të Shkollës së doktoratës duke përfshirë procedurën për regjistrim, organizimin e mësimit dhe mentorimit, monitorimin e progresit, vlerësimin dhe fitimin e titullit shkencor 'Doktor i shkencave'.

#### *Neni 3*

Studimet e ciklit të tretë organizohen në bazë të programeve studimore të akredituara. Hulumtimi mund të organizohet gjithashtu si program i përbashkët (joint degree), në partneritet me institucione tjera ndërkombëtare të arsimit të lartë.

### **Kushtet për regjistrim të studentëve**

#### *Neni 4*

Kushtet minimale për regjistrim në ciklin e tretë të studimeve janë kandidati të ketë notë mesatare 8 në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, titullin Magjistër (Master) dhe të ketë akumuluar së paku 300 pikë ECTS. Për programe të veçanta studimore mund të aplikohen edhe kushte tjera specifike për regjistrim.

Regjistrimi i kandidatëve në programin studimor të studimeve të ciklit të tretë bëhet në bazë të Konkursit të shpallur ku në mënyrë precize janë të përcaktuara kushtet dhe kriteret për regjistrim.

Universiteti do të regjistrojë studentët profili i hulumtimit të të cilëve përputhet me profilin hulumtues të mentorëve të akredituar.

### **Kushtet e programeve studimore**

#### *Neni 5*

Studimet e ciklit të tretë zgjasin së paku tre vjet me 180 kredi (ECTS) të fituara. Aktivitetet e domosdoshme brenda programeve studimore përfshijnë:

- Trajnim akademik me lëndë të avancuara dhe profesionale;
- Propozim tezën e doktoratës;
- Minimum një javë mobilitet ndërkombëtar;
- Prezantime publike të progresit në disertacionin e doktoratës;
- Dy publikime në revista shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, në lidhje me punën e doktoratës; dhe
- Punim dhe mbrojtje publike të disertacionit të doktoratës.

Distribrimi i kredive për secilin nga këto aktivitete akademike definohet në programet studimore.

Me mbrojtjen publike të suksesshme të disertacionit të doktoratës fitohet titulli shkencor - Doktor i shkencave.

Të gjitha dokumentet dhe vendimet relevante ruhen në Fakultet. Aplikimi dhe notat ruhen në Zyrën e regjistrimit. Certifikatat dhe diplomatat ruhen në arkiv, ndërsa kopjet e disertacionit të doktoratës ruhen në fakultet dhe bibliotekë.

### **Pagesat për studime**

#### *Neni 6*

Studentët paguajnë kompensim për studime për programin përkatës të studimeve në bazë vjetore. Shuma caktohet nga Bordi i Universitetit dhe publikohet në Konkursin për regjistrim të studentëve.

Zyra e bursarit merret me të gjitha pagesat për studim duke përfshirë edhe pagesat e vonuara.

#### *Neni 7*

Pagesa për studime mund të paguhet në më shumë mënyra.

Studentët mund të paguajnë kompensimin e tyre për studime për gjithë vitin akademik paraprakisht kur të regjistrohen. Për studentët që paguajnë paraprakisht për gjithë vitin akademik mundësohet lehtësim prej 3% nga detyrimi vjetor.

Studentët mund gjithashtu të bëjnë pagesën për studime në dy ose katër këste. Studentët që zgjedhin pagesën në dy këste duhet të bëjnë pagesën e semestrit dimëror më së voni gjer 30 shtator kurse pagesën e semestrit veror gjer 28 shkurt të vitit gjegjësisht akademik.

Studentët që zgjedhin pagesën e studimit ta bëjnë në katër këste duhet të bëjnë atë në 4 pagesa të barabarta sipas këtij plani:

- 30 shtator;
- 31 dhjetor;
- 31 mars;
- 31 maj.

Për studentët që zgjedhin të paguajnë detyrimet në katër këste aplikohet ngarkesë/pagese shtesë.

### **Pagesat për reregjistrim**

*Neni 8*

Studentët të cilët reregjistrojnë lëndë paguajnë pagesë për reregjistrim në lartësi të 25% të kredive të lëndës.

### **Pagesat e vonuara**

*Neni 9*

Nëse në llogarinë e studentit vërehet tejkalim i afatit të pagesës, Zyra e bursarit lëshon Kujtesë zyrtare dhe në këtë rast do të aplikohet ngarkesë/pagese shtesë për pagesën e vonuar. Atëherë studentit do t'i jepet një afat prej 14 ditë kalendarike për ta realizuar pagesën e mbetur.

Nëse edhe pas këtij afati studenti nuk e ka bërë pagesën atëherë atij do t'i dërgohet Kujtesa e dytë për pagesat e vonuara dhe përsëri do t'i jepet një afat prej 14 ditëve për të bërë pagesën. Pas dërgimit të Kujtesës së dytë qasja e studentit në shërbimet/pajisjet e universitetit do të pezullohet. Kjo përfshin - por nuk kufizohet me - lëshimin e transkriptave, certifikatave dhe diplomave, qasjen në rrjetën kompjuterike (duke përfshirë Learning Management System), bibliotekë, Sistemin informativ universitar (formën e regjistrimit, regjistrimin e lëndës, regjistrimin e provimit). Kjo dispozitë do të zbatohet derisa detyrimi të jetë përmbushur dhe statusi "i bllokuar" të jetë fshirë nga zyra përkatëse.

Nëse llogaria e studentit nuk barazohet brenda katërmëdhjetë (14) ditëve kalendarike nga Kujtesa e dytë, statusi i studentit do shëndrohet në status joaktiv. Kjo nënkupton të gjitha shërbimet akademike dhe administrative bllokohen.

Nëse studenti e di se do të ketë vështirësi në përmbushjen e pagesës, duhet të kontaktojë Zyrën e bursarit, përpara datës së pagesës, për të shqyrtuar një mundësi alternative.

## **Llogaritë e studentëve**

*Neni 10*

Universiteti hap llogari për secilin student me qëllim të mbajtjes së shënimeve për detyrimet financiare dhe kredive SETK. Pagesa për studime dhe pagesat tjera regjistrohen në llogarinë e studentit.

## **Shkolla e doktoratës**

*Neni 11*

Studimet e ciklit të tretë realizohen në kuadër të shkollës së integruar të doktoratës. Shkolla e doktoratës mbikqyr aktivitetet dhe standardet për studimet e doktoratës dhe përkrahjen për studentët e ciklit të tretë.

Struktura e shkollës së doktoratës është si vijon:

- Këshilli i shkollës së doktoratës i cili është përgjegjës për qeverisjen akademike;
- Drejtori i shkollës së doktoratës menaxhon punën e shkollës në nivel të Universitetit;
- Këshilltari studentor i ciklit të tretë të studimeve siguron përkrahje administrative teknike për studentët, drejtorin dhe Këshillin.

Në nivel të fakultetit, dekani udhëheq dhe menaxhon programet e doktoratës me përkrahjen e dekanatit. Qeverisja akademike në fakultet bëhet nëpërmjet Këshillit mësimor shkencor të fakultetit.

## **Përbërja e këshillit të shkollës së doktoratës**

*Neni 12*

Këshillin e Shkollës së doktoratës e përbëjnë 8 anëtarë:

- Prorektori për hulumtim (ex-officio) – Kryesues;
- Prorektori për çështje akademike (ex-officio);
- Drejtori i shkollës së doktoratës (ex-officio);
- Pesë anëtarë, një nga çdo fakultet, së paku me thirrje profesor inordinar, të cilët propozohen nga Rektori në konsultim me dekanët dhe zgjidhen nga Senati me mandat 3 vjeçar.

Mandati i anëtarëve ex-officio zgjat në përputhje me kohëzgjatjen e funksioneve të tyre.

## **Definimi i përgjegjësive**

*Neni 13*

Përgjegjësitë e Këshillit të studimeve të doktoratës të universitetit janë si vijon:

- Zhvillon politika rregullatore dhe kornizë operacionale;
- I konfirmon programet studimore të ciklit të tretë të propozuara nga fakultetet dhe institutet për procesim të mëtutjeshëm dhe aprovim në Senat;
- E konfirmon draftin e Konkursit për regjistrim të studentëve në studimet e doctorates, të propozuara nga fakultetet/institutet për procesim të mëtutjeshëm dhe aprovim në Senat;

- Formon komitete punuese që përbëhen nga Prorektori për çështje akademike si kryesues, Drejtori dhe një anëtar i Këshillit për studimet e ciklit të tretë nga fakulteti gjegjës për monitorim të procesit për mbrojtje;
- I informon Këshillat mësimor shkencor për punën dhe vendimet e Këshillit të studimeve të doktoratës;
- Voton me shumicë të thjeshtë me kuorum 50% plus një anëtar ku Kryesuesi, në rast të votimit të barabartë, ka votën vendimtare;
- I kthen vendimet të cilët nuk konfirmohen, për rishqyrtim në fakultet. Vendimi i Këshillit të shkollës së doktoratës është final;
- Shqyrton dhe vendos për ankesat e shkollës së dytë, me apelim përfundimtar te Rektori.

Përgjegjësitë e Komiteteve punuese janë si vijon:

- Monitoron zgjedhjen e mentorit dhe në rast të konstatimit për mospërputhje të fushës së hulumtimit të mentorit me propozim tezën e disertacionit;
- Monitoron (si fjalë a është adekuate) zgjedhjen nga fakulteti të anëtarëve të komisionit për mbrojtje;
- Para mbrojtjes konfirmon se dokumentacioni i dorëzuar për kandidatin është konform kushteve;
- E informon dekanatin për të caktuar datën e mbrojtjes;
- I referon rastet ku ka mospajtim procedural te Këshilli i shkollës së doktoratës për vendim final.

Përgjegjësitë e drejtorit të shkollës së doktoratës janë si vijon:

- I raporton Prorektorit përgjegjës për hulumtim;
- Koordinon punën e shkollës së doktoratës në bashkëpunim me dekanin ose personin e nominuar;
- Kontribuon për evaluimin dhe zhvillimin e Shkollës së doktoratës në bashkëpunim me fakultetet dhe Këshillin e studimeve të doktoratës;
- Bashkëpunon me prorektorin përgjegjës për hulumtime, dekanët dhe personin e nominuar me qëllim të zhvillimit dhe promovimit të punës kërkimore-shkencore në procesin studimor;
- Kontribuon për planin promovues dhe regjistrimin e studentëve në bashkëpunim me fakultetet, shërbimet studentore dhe zyrën përgjegjëse për promovim;
- Menaxhon përmbajtjen e uebfaqes së Shkollës së doktoratës në bashkëpunim me fakultetet dhe zyrën përgjegjëse për promovim;
- Kontribuon për zhvillimin dhe implementimin efektiv të procedurave relevante, udhëzimeve, informatave për studimet, përgatitë raporte vjetore;
- Këshillon studentë, jep informata ad hoc dhe me shkrim, në bashkëpunim me departamentet gjegjëse;
- Pranon dhe përpunon ankesat me shkrim në lidhje me shkollën e doktoratës deri në kthimin e përgjigjes personit i cili ka dorëzuar ankesën;

Përgjegjësitë e këshilltarit studentor janë si vijon:

- Jep informata bazike dhe këshilla, aplikantëve dhe studentëve në bashkëpunim me drejtorin e shkollës së doktoratës;
- Siguron të dhëna dhe raporte relevante për drejtorin e shkollës së doktoratës;
- Merr shënime nga mbledhjet e këshillit të studimeve të doktoratës;

**Roli i këshillit mësimor shkencor i fakultetit**

#### *Neni 14*

Në nivel të fakultetit, përgjegjësinë për stafin dhe monitorimin e progresit të studentëve e ka zyra e dekanit në bashkëpunim me drejtorin. Vendimet formale merren nga Këshilli mësimor shkencor. Për çështjet lidhur me studimet e ciklit të tretë të drejtë vote kanë të gjithë anëtarët me thirrje mësimore shkencore.

Përgjegjësitë e Këshillit mësimor shkencor të fakultetit janë si vijon:

- Zhvillon Propozim-programe studimore për ciklin e tretë për konfirmim nga Këshilli i studimeve të ciklit të tretë dhe aprovim nga Senati;
- I shqyrton dhe jep mendim, sipas propozimeve, për organizim të programeve studimore të përbashkëta të doktoratës për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe aprovim;
- Inicon procedure për akreditimin e mentorëve në pajtim me dispozitat ligjore;
- Përkufizon numrin e studentëve nëpër programe studimore në konkursin për regjistrim;
- I determinon kriteret plotësuese në pajtim me profilin e studentit;
- I shqyrton aplikacionet dhe i propozon kandidatët për pranim Këshillit për ciklin e tretë të studimeve;
- Përcakton mentorët e studentëve sipas fushës së hulumtimit dhe i informon ata me shkrim;
- Shqyrton kërkesat nga Komiteti punues i Këshillit të studimeve të doktoratës;
- Shqyrton dhe vendos për përshtatshmërinë e propozim tezës së doktoraturës dhe të kandidatit dhe miraton Planin individual të studentit;
- Shqyrton raportin e mentorit për progresin e kandidatit sipas Planit individual të studentit;
- Emëron Komisionet për mbrojtje të doktoratës;
- Miraton raportin përfundimtar të komisionit për mbrojtje dhe e proceson deri te Komiteti punues për verifikim procedural;

#### **Mentori**

##### *Neni 15*

Mentori duhet të ketë thirrje mësimore-shkencore profesor i rregullt ose profesor inordinar dhe të jetë i/e akredituar nga Bordi i akreditimit. Mentori duhet të jetë hulumtues aktivë, i/e kyçur në projekte lokale, regjionale dhe/ose ndërkombëtare dhe të njeh në nivel akademik gjuhën e shkrimit dhe mbrojtjes së disertacionit të doktoratës.

Për secilin kandidat, Këshilli mësimor shkencor përcakton mentorin pas mbarimit të semestrit të parë të studimeve. Një profesor mund të jetë mentor i më së tepërmi tre doktorantëve. Ai/ajo nuk mund të mentorojë në më tepër se dy programe studimore, përveç në rastet e programeve inter-disciplinare.

Me kërkesë të arsyeshme të kandidatit, mentori mund të ndërrohet. Për këtë, Vendim sjell Këshilli mësimor shkencor i Fakultetit me të drejtë apelimi të këtij Vendimi deri te Këshilli i Shkollës së doktoratës.

Me kërkesë të arsyeshme të mentorit për tërheqje nga mentorimi, mentori mund të ndërrohet. Për këtë, Vendim sjell Këshilli mësimor shkencor i Fakultetit me të drejtë apelimi të këtij Vendimi deri te Këshilli i Shkollës së doktoratës.

Detyrat e mentorit janë:

- Të udhëheq dhe këshillojë rregullisht kandidatin për të gjitha aspektet e hulumtimit gjatë studimeve;
- Të përgatisë, me kandidatin, planin individual për hulumtim i cili përfshinë orarin e takimeve dhe raportimin e progresit;
- Ta përkrahë kandidatin gjatë pregaditjes së propozim tezës së doktoratës për aprovim nga Këshilli mësimor-shkencor të fakultetit;
- Të japë mendim, sugjerime, vështrime dhe propozime gjatë punës së disertacionit;
- Të këshillojë dhe motivojë studentin për vendosjen e kontakteve nacionale dhe ndërkombëtare me botën kërkimore, kërkimin e fondeve dhe mobilitet;
- Të përkrahë studentin në aktivitetet publike të punimeve kërkimore shkencore;
- Të ndërmer përgjegjësi për cilësinë dhe validitetin e punës hulumtuese, rezulateve dhe disertacionit të kandidatit;
- Të bashkëpunojë me dekanin e fakultetit gjegjës dhe drejtorin e shkollës së doktoratës për organizimin e dy prezantimeve gjatë punës në disertacionin e doktoratës;
- Të dorëzojë te dekani ose personi i nominuar, një herë në gjashtë muaj, raporte të shkruara për progresin e punimit të disertacionit të doktoratës.
- Të dorëzojë, te Këshilli mësimor shkencor i fakultetit, raportin final për versionin e fundit të disertacionit të doktoratës ku do të konfirmojë se disertacioni është i gatshëm për mbrojtje, është i cilësisë së mirë, i përmbush të gjitha kriteret ligjore dhe teknike dhe është punë individuale e kandidatit.

### **Komisioni për mbrojtje**

*Neni 16*

Komisioni për mbrojtje përbëhet nga pesë anëtarë prej të cilëve katër janë nga lëmi përkatës dhe një nga lëmi i përfaqësuar. Një anëtar i komisionit është ndërkombëtar.

Anëtarë komisioni janë profesorë inordinar dhe profesorë të ordinar.

Para mbrojtjes emërohet kryetari i komisionit për mbrojtje publike nga radhët e komisionit.

Për rrjedhën e mbrojtjes publike mbahet procesverbali zyrtar, të cilin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit.

### **Aftësimi për hulumtim**

*Neni 17*

Aftësimi për hulumtim përfshinë trajnim për punë hulumtuese, mësim lidhur me lëmin shkencor dhe përkrahje në lidhje me pregaditjen dhe mbrojtjen e disertacionit të doktoratës.

*Neni 18*

Profesori është përgjegjës për përkufizimin e notës për lëndën, të bazuar në evaluimin e punës së kompletuar të kandidatit. Profesori i shënon notat në sistemin elektronik të notimit dhe këto nota regjistrohen nga Zyra e regjistrimit. Fakulteti e menaxhon procesin e vlerësimit dhe të gjitha notat për atë

vit akademik duhet të regjistrohen në sistem deri më 1 (një) shtator. Me kërkesë të studentit profesori është përgjegjës për dhënien e informatës kthyesë.

Notat shënohen në transkriptë në bazë të sistemit për notim të shënuar më poshtë:

Shkalla e vlerësimit		Përshkrimi	Nota	Nota me shkronja
<i>Nga</i>	<i>Deri</i>			
95%	-100%	Shembullor	10	A/A+
85%	-94%	Shkëlqyeshëm	9	A-/B+
75%	-84%	Shumë mirë	8	B-
65%	-74%	Mirë	7	C
51%	-64%	Mjaftueshëm	6	D
0%	-50%	Pamjaftueshëm	5	F
		E papërfunduar (IN)	n/a	
		Pa të dhëna (NR)	n/a	

### ***E papërfunduar (IN)***

Vlerësimi *Incomplete-IN* mund të jepet nëse studenti nuk i ka kryer të gjitha kërkesat për lëndën deri në fund të semestrit, por ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të punës.

Është përgjegjësi e studentit që t'i sjellë informata përkatëse mësimdhënësit dhe të arrihet një marrëveshje me të cilën kërkesat e mbetura do të plotësohen. Mësimdhënësi do ta dorëzojë notën finale tek Shërbimi për studentë kur studenti të ketë dorëzuar të gjithë punën e kërkuar. Nëse kërkesat e parashtruara nuk përmbushen brenda një viti, automatikisht shënohet nota pamjaftueshëm.

### ***Nuk ka të dhëna për notën (NR)***

Ky shënim do të shkruhet në transkriptën e studentit në rastet kur studentit është regjistruar në lëndën specifike dhe nuk ka marrë notë nga mësimdhënësi. Kjo nuk ndikon në notën e përgjithshme mesatare të studentit dhe mund të ndryshohet në notë kur mësimdhënësi e dorëzon notën formale.

Kandidati mund të ankimojë notën te dekani/drejtori në afat prej 24 orëve nga publikimi i notës. Procedura e ankimit procesohet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror. Për rastet e sëmundjes/pushimit të lehtë vlejné dispozitat ligjore.

### **Propozim teza e doktoratës**

*Neni 19*

Pas semestrit të parë studentit fillon me zhvillimin e propozim tezës së doktoratës në bashkëpunim me mentorin.

Propozim teza e doktoratës përfshinë:



- deklaratën e nënshkruar nga kandidati me të cilën ai/ajo i bart Universitetit të drejtat autoriale të punimit për përdorim për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese;
- shënimet personale;
- biografinë e shkurtër akademike me bibliografinë e punimeve shkencore të publikuara;
- titullin e propozim tezës së doktoratës;
- fushën e studimeve;
- rezimënë e shkurtër e temës me hipotezat që ngre kandidati, rëndësinë dhe arsyeshmërinë e saj për zhvillimin e përgjithshëm shkencor, shoqëror, zbatueshmërinë në praktikë, lidhshmërinë e tezës me industrinë apo komunitetin;
- metodologjitë e hulumtimit që do të përdoren gjatë punës hulumtuese;
- strukturën e disertacionit;
- literaturën/bibliografinë fillestare që kandidati mendon të shfrytëzojë;
- planin individual të hulumtimit i cili përfshin planin kohor për aktivitetet hulumtuese, planin e mobilitetit dhe publikimeve dhe prezantimin e progresit në hulumtim.

#### *Neni 20*

Kandidati dorëzon propozim tezën e doktoratës te dekanati i fakultetit gjegjë, me kërkesë për lejimin e punës në tezën e doktoratës.

Këshilli mësimor shkencor i fakultetit shqyrton kërkesën e kandidatit, të prezentuar nga mentori, dhe lejon fillimin e punës së tezës së doktoratës ose e kthen për punë të mëtutjeshme. Vendimi i jepet kandidatit, mentorit dhe arkivit të fakultetit. Proçesi duhet të mbarojë brenda 30 ditëve pas dorëzimit të kërkesës.

Kandidati mund të ankohet, te Këshilli i shkollës së doktoratës, kundër vendimit të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit në afat prej 15 ditësh. Në këto raste Komiteti i Këshillit të shkollës së doktoratës bie Vendim në afat për 15 ditë dhe informon palët relevante.

Vendimet pozitive së bashku me titullin e temës, emrin e kandidatit dhe të mentorit shpallen nga Fakulteti në uebfaqen e Shkollës së doktoraturës në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze.

#### **Disertacioni i doktoratës**

##### *Neni 21*

Disertacioni i doktoratës është punë e pavarur shkencore hulumtuese dhe paraqet kontribut për zhvillimin e një fushe shkencore.

Hulumtimin shkencor, që është pjesë e disertacionit të doktoratës, kandidati mund ta kryejë në Fakultetin ose Institutin përkatës për hulumtime shkencore në Universitet apo në ndonjë qendër të huaj hulumtuese - shkencore.

Disertacioni i doktoratës duhet të:

- shkruhet në një nga gjuhët zyrtare të Universitetit ose në gjuhën e studiuar, e zgjedhur ngakandidati, me apstrakt të obligueshëm në dy gjuhët;
- ketë 150 faqe vëllim minimal;

- strukturohet me ballinë, përkushtim (nëse ka), abstrakt, parafjalë; përmbajtje me kapituj, konkluzione dhe bibliografi;
- këtë formatin në pajtim me stilin APA dhe të përdor fontin 'Calibri'.

Ballina e disertacionit të doktoratës është me ngjyrë të kuqe e errët dhe përmban:

- Emrin e universitetit (në anën e majtë - lartë të faqes);
- Emrin e fakultetit (në anën e djathtë - lartë të faqes);
- Logon e universitetit (ndërmjet universitetit dhe fakultetit);
- Titullin 'Cikli i tretë i studimeve' (në mes të faqes); i pasuar nga titulli i disertacionit;
- Titullin 'Tema e disertacionit të doktoratës:' i pasuar nga
- Emrin dhe mbiemrin e kandidatit (në anën e majtë - poshtë të faqes);
- Emrin dhe mbiemrin e mentorit (në anën e djathtë - poshtë të faqes);
- Muajin dhe vitin e mbrojtjes së disertacionit të doktoratës (në mes të rreshtit - në fund të faqes).

Disertacionin i doktoratës duhet të përfshijë një deklaratë të shkruar dhe të firmosur ku do të thuhet: "Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi."

Para dorëzimit të versionit të përfunduar të disertacionit të doktoratës, kandidatët janë të obliguar që punimin ta lekturojnë nga një profesionist i licencuar dhe i autorizuar.

### **Prezantimi i progresit**

*Neni 22*

Kandidati i doktoratës dhe mentori duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm në pajtim me planin individual për hulumtim, për të diskutuar progresin e disertacionit.

Gjatë punimit të disertacionit të doktoratës, kandidati i doktoratës, në bashkëpunim me mentorin, ka për obligim të bëjë dy prezantime publike para komunitetit akademik. Mentori dorëzon kërkesë formale për prezantimin e parë dhe të dytë publik, për progresin në punën e doktoratës, për aprovim nga dekanit dhe drejtori i shkollës së doktoratës. Zyra e dekanit i publikon këto prezantime minimum një javë përpara, nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim.

Kandidati dhe mentori mund të shqyrtojnë komentet dhe këshillat e dhëna, gjatë prezantimeve, për përmirësimin e disertacionit dhe duhet t'i përfshinë këto në raportin gjashtëmuor.

### **Mbrojtja e disertacionit të doktoratës**

*Neni 23*

Studimet e doktoratës përfundojnë me mbrojtjen publike të disertacionit të doktoratës. Nëse studenti nuk i përmbush kërkesat e programit studimor dhe nuk e mbron disertacionin në afatin e paraparë në programin studimor prej tre vitesh nga dita e regjistrimit në studimet e doktoratës, kalon në statusin - absolut/pasiv. Njëherit mentori renditet në listën e mentorëve aktiv dhe fiton të drejtën e konkurimit për kandidat të ri.

Studenti i cili kalon ne statusin pasiv vazhdon me punë kërkimore individuale drejt përfundimit të disertacionit të doktoratës. Nëse studenti nuk e mbron disertacionin e doktoratës në afat prej 6 vitesh nga data e regjistrimit në studimet e doktoratës, ai e humb statusin e studentit. Studenti mund të aplikojë te Këshilli i shkollës së doktoratës për zgjatjen e këtij afati para se ai të përfundojë. Vendimi i Këshillit të shkollës së doktoratës është përfundimtar.

Nëse studenti gjatë kohëzgjatjes së studimeve nuk arrin të tregojë progres adekuat, atëherë mund të kërkohet ti ndërpritet statusi i studentit. Kushtet bazë të mospërmbushjes së progresit janë:

- nëse në afat prej dy vitesh e gjysëm ai/ajo nuk i ka përfunduar me sukses provimet e parapara në programin studimor dhe nuk i është miratuar propozim teza e doktoratës;
- nëse ai/ajo nuk i përmbush obligimet e parapara në planin individual të hulumtimit;

Kërkesa për ndërprerje të statusit të studentit mund të bëhet nga mentori ose Dekani i Fakultetit gjegjës. Kërkesa e këtillë, me arsyetimin për mungesën e progresit shqyrtohet në Këshillin mësimor-shkencor të Fakultetit. Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit mund ti propozojë Këshillit të shkollës së doktoratës ndërprerjen e statusit të studentit për mungesë të progresit në studime. Me këtë propozim njoftohet edhe studentin, i cili ka të drejtë të ankimojë këtë propozim në afat prej 15 ditësh në Këshillin e shkollës së doktoratës. Vendimi i Këshillit të shkollës së doktoratës do të jetë përfundimtar.

Procedura e mbrojtjes zgjatë maksimum 6 muaj.

Pas përfundimit të shkrimit të disertacionit të doktoratës dhe pasi që mentori vlerëson se kandidati ka përfunduar me sukses hartimin e tij, mentori i paraqet raport Këshillit mësimor shkencor të fakultetit për aprovim brenda 30 ditëve pas pranimit të disertacionit nga kandidati.

Raporti i mentorit përmban:

- Emrin dhe mbiemrin e mentorit;
- Emrin dhe mbiemrin e kandidatit;
- Titullin e temës;
- Deklaratën e mentorit që konfirmon se puna e kandidatit është e pavarur dhe pa plagjiaturë;
- Analizën e hulumtimit të ndërmarë në disertacion duke përfshirë të dhëna për titullin e temës, situatën aktuale në lëmin shkencor të disertacionit, përshkrim i metodave hulumtuese të përdorura, përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit;
- Konkluzën që përfshin kontributin kryesor të hulumtimit të kandidatit, aplikueshmëria dhe përkufizimet, sugjerimet për punën e mëtejshme hulumtuese;
- Propozim Këshillit mësimor shkencor për aprovim të disertacionit;
- Nënshkrimi original i mentorit.

Në qoftë se provohet se disertacioni i doktoratës përmban material të kopjuar (plagjiat) ose është punim i kopjuar (plagjiaturë), atëherë studenti do të trajtohet në pajtim me Rregulloren për sjellje të studentëve dhe nga studenti mund të kërkohet që menjëherë të largohet nga universiteti, pa të drejtë kthimi. Nëse zbulohet plagjiatura pasiqë mentori e ka nënshkruar raportin, atëherë edhe mentori do të ftohet para komisionit disiplinor të sqarojë arsyen e dështimit të zbulimit të plagjiaturës.

Komisioni për mbrojtje konfirmohet pas pranimit të raportit të mentorit nga Këshilli mësimor shkencor.

Dekanati organizon ekspozimin e disertacionit në bibliotekë për 15 ditë duke përfshirë edhe 'view-only' format. Komentet relevante eventuale të pranuar gjatë kësaj periudhe mblidhen nga dekanati dhe i dorëzohen komisionit të mbrojtjes së bashku me disertacionin e kandidatit.

Komisioni për mbrojtje e vlerëson disertacionin e doktoratës dhe përgadit raport i cili mund të përfshijë edhe mendimin e ndarë të ndonjërit anëtar të komisionit. Ky raport i dorëzohet dekanatit në afat prej 30 ditëve.

Këshilli mësimor shkencor i fakultetit verifikon se nuk ka vërretje serioze në raportin e komisionit për mbrojtje dhe dërgon dokumentacionin e disertacionit, raportin dhe komentet te komiteti punues relevant në shkollën e doktoratës për të kontrolluar mbarëvajtjen e procesit. Pas vendimit pozitiv të komitetit, drejtori i shkollës së doktoratës e informon dekanin i cili pastaj cakton datën e mbrojtjes.

Kandidati është i obliguar t'i dorëzojë dekanatit së paku tetë kopje të disertacionit për përdorim gjatë procesit të mbrojtjes.

#### *Neni 24*

Kandidati mbron publikisht disertacionin e doktoratës para komisionit për mbrojtje.

Mbrojtja e disertacionit të doktoratës zhvillohet në lokalet e Universitetit. Dita dhe vendi i mbrojtjes publike, emri i kandidatit dhe titulli i disertacionit publikohen në ueb faqen e shkollës së doktoraturës së paku 7 ditë para mbrojtjes publike.

#### *Neni 25*

Mbrojtja e disertacionit të doktoratës zhvillohet sipas rendit në vijim:

- Kryetari i komisionit mban fjalën hyrëse me të cilën e hap mbrojtjen publike. Fjala hyrëse përfshin dhe një përmbledhje të recensionit dhe vlerësimit të disertacionit;
- Kryetari i komisionit e fton kandidatin që ta prezantojë dhe arsyetojë disertacionin e doktoratës;
- Kryetari i komisionit i jep fjalën mentorit dhe anëtarëve të komisionit për ta dhënë mendimin e tyre për disertacionin;
- Anëtarët e komisionit i bëjnë pyetje kandidatit;
- Kandidatit i mundësohet një kohë e arsyeshme për përgaditjen e përgjigjeve;
- Komisioni tërhiqet për të marr vendimin lidhur me mbrojtjen e disertacionit të doktoratës.

#### *Neni 26*

Kryesuesi i komisionit e komunikon vendimin e komisionit dhe atë me njërin nga vlerësimet:

- E mbrojti disertacionin e doktoraturës; ose
- Nuk e mbrojti disertacionin e doktoratës

Pas mbrojtjes anëtarët e komisionit e nënshkruajnë procesverbalin e mbrojtjes publike dhe ai me të gjitha dokumentet i dorëzohen shërbimit fakultetit përkatës për arkivim.

#### *Neni 27*

Pas mbrojtjes së suksesshme, kandidatit i lëshohet certifikata dhe diploma për fitimin e shkallës doktor shkencash nga ana e zyrës të regjistrimit, në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze.

Njëherë në vit Universiteti organizon ceremoni promovuese për doktorët e shkencave. Me promovimin udhëheqë Rektori i universitetit.

### **Dispozitat përfundimtare**

*Neni 28*

Studentët të cilët kanë filluar studimet e doktoratës me sistemin mentorial i mbarojnë ato në bazë të Rregullores për doktoratë – sistemi mentorial nga data 13 qershor 2005.

*Neni 29*

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Senati.